

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
„HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

***DALLIMET NË SHKALLËN E VLERËSIMIT TË RËNDËSISË SË TË
USHTRUARIT TË RREGULLT NË MES TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE
TË MESME DHE PERSONAVE AKTIV NË FITNES***

Mentori
Prof.Dr.Asc.Musa Selimi

Kandidati-ja:
Agnesa Rexha

Prishtinë, 2017

PERMBAJTJA

| | |
|--|----|
| 1. HYRJA | 4 |
| 2. HULUMTIMET E DERITANISHME | 9 |
| 3. KARAKTERISTIKAT ZHVILLIMORE TE VAJZAVE DHE DJEMVE TE MOSHES SË MESME SHKOLLORE | 11 |
| 4. NDIKIMI I AKTIVITETEVE FIZIKE NË ORGANIZMIN E NJERIUT | 14 |
| 5. METODOLOGJIA | 15 |
| 5.1. QËLLIMI | 16 |
| 5.2. PYETJET HULUMTUESE | 17 |
| 5.3. HIPOTEZAT | 18 |
| 5.4. MOSTRA E HULUMTIMIT | 19 |
| 5.5. INSTRUMENTI DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE | 20 |
| 5.6. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE | 23 |
| 6. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE | 24 |
| 6.1. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR - GRUPI I MESHKUJVE AKTIV | 24 |
| 6.2. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR GRUPI I MESHKUJVE PASIV NË FITNES | 26 |
| 6.3. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR - GRUPI I FEMRAVE AKTIVE NË FITNES | 28 |
| 6.4. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR GRUPI I FEMRAVE PASIVE NË FITNES | 30 |
| 7. NDRYSHIMET NË MES TË GRUPEVE | 32 |
| 7.1. NDRYSHIMET NË MES TË GRUPIT TË MESHKUJVE AKTIV NË FITNES DHE SEDENTARË | 32 |
| 7.2. NDRYSHIMET NË MËS TË GRUPIT TË FEMRAVE AKTIVE NË FITNES DHE SEDENTARE | 37 |

| | |
|--|----|
| 7.3. NDRYSHIMET NË MËS TË GRUPIT TË FEMRAVE DHE MESHUJVE AKTIVE NË FITNES | 37 |
| 7.4. PËRQINDJA E SHPËRNDARJES SË REZULTATEVE SIPAS GRUPEVE DHE STATUSIT TË TYRE TË AKTIVITETIT FIZIK - MESHKUJT | 39 |
| 7.5. PËRQINDJA E SHPËRNDARJES SË REZULTATEVE SIPAS GRUPEVE DHE STATUSIT TË TYRE TË AKTIVITETIT FIZIK – FEMRAT | 40 |
| 8. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE | 42 |
| PYETJET HULUMTUESE | 42 |
| 9. REZYME..... | 44 |
| 10. PËRFUNDIME ME REKOMANDIME | 45 |
| 11. LITERATURA | 49 |

ABSTRAKTI

Qëllimi: Qëllim i këtij studimi është të krahasohet shkalla e përceptimit në përfitimet dhe pengesat nga të marruarit me ushtrime të fitnesit në mes të personave aktiv në fitnes, që mund të jenë studentë, punëtor etj dhe nxënësve të shkollës së mesme të cilët nuk janë aktiv në procesin e të ushtruarit. Po ashtu qëllim në vete është që të vërtetohen edhe qëndrimet të cilat i mbajnë nxënësit e shkollës së mesme ndaj përfshirjes së rregullt të tyre në procesin stërvitorë, me theks të veçantë në gjetjen e arsytetimeve të cilat do i paraqesin nxënësit për mos aktivitetin e tyre fizik. Në këtë hulumtim është trajtuar popullata e nxënësve të moshës 15-18 vjeçarë, nxënës të shkollës së mesme, vijues të shkollave në komunën e Mitrovicës nga vendbanimet urbane dhe ato rurale. Në mostrën e këtij hulumtimi janë të përfshirë **150 persona aktiv**, përkatësisht 75 meshkuj dhe 75 femra aktive (mbi 1 vit aktiv) dhe **150 persona sedentar**, prej tyre 75 janë të gjinisë mashkullore dhe 75 të gjinisë femërore të cilët janë sedentar (jo aktivë).**Metodat:** Instrumenti për mbledhjen e të dhënave me qëllim të përcaktimit të shkallës e të përfitimeve të marrurit me fitnes në mes të personave aktiv dhe nxënësve të shkollës së mesme te cilët llogariten si popullatë sedentare është përdorur pyetësori i standardizuar "The Exercise Benefits/Barreires Scale" (EBBS) i cili në Gjuhën Shqipe përkthehet si "Shkalla e matjes/përceptimit të përfitimeve/barrierës nga ushtrimet" e prodhuar nga **Sechrist, KR, Ealker, SN, & Pender, NJ. (1987).****Rezultatet:** Rezultatet e fituara kanë arritur që të vërtetojnë hipotezat e parashtruara sepse në shumicën (43 pyetje) janë paraqitur ndryshime të rëndësishme statistikore të cilat kanë treguar se në mes të personave të cilët merren në mënyrë aktive me të ushtruarit fizik (të cilët kryesisht janë vizitues të rregullt të klubeve të fitnesit dhe pjestarë të klubeve sportive) kanë qëndrime më pozitive ndaj procesit të ushtruarit. Kjo vërteton faktin se të ushtruarit e individëve të caktuar është i lidhur shumë me qëndrimet të cilat ata mbajnë ndaj edukimit fizik dhe të qenit aktiv.

Fjalët kyce: Fitnes, Sedentarë, Qëndrime, Shprehi, Të ushtruarit

ABSTRACT

Purpose: The purpose of this study is to compare the degree of perception in the benefits and obstacles of regular fitness exercises between active persons in fitness, who may be students, workers etc. and high school students who are not active in the exercise process. It is also intended to validate the attitudes that keep the high school students to their regular involvement in the training process, with particular emphasis on finding the reasons that the students will present to their physical activity .The survey covered the population of students aged 15 to 18 years, high school students, school attendants in Mitrovica municipality from urban and rural settlements. In the sample of this research are included 150 active persons, respectively 75 males and 75 active women (over 1 active year) and 150 sedentary persons, of which 75 are male and 75 females who are sedentary (not active) . **Methods:** The Data Collection Tool for the purpose of determining the degree and the gain of the fit between active persons and high school students who are counted as sedentary population is using the standardized questionnaire "The Exercise Benefits / Barreires Scale "(EBBS) which translates into the Albanian Language as the" Measurement / Perception Rate of Benefits / Barriers to Exercise "produced by Sechrist, KR, Walker, SN, and Pender, NJ. (1987). **Results:** The obtained results have been able to prove the hypotheses put forward because in most (43 questions) significant statistical changes have been shown that among those who are actively engaged in physical exercise (who are mainly visiting regular fitness clubs and members of sports clubs) have more positive attitudes towards the exercise process. This proves the fact that the exercise of certain individuals is closely related to the attitudes they hold to physical education and being active.

Key words: Fitness, Sedentary, Attitude, Expression, Exercise

1. HYRJA

Koncepti për vlerën e sportit ka ndryshuar gjatë zhvillimit historik të njeriut. Aktiviteti fizik është shfrytëzuar në mënyra të ndryshme dhe i ka shërbyer përmbushjes së qëllimeve të llojllojshme. Aktiviteti fizik është i njohur qysh në kohërat e lashta si në Greqi, Romën e lashtë që ka pasur për qëllim përgatitjen psiko-fizike të fëmijëve, rinisë dhe luftëtarëve nëpërmjet aktiviteteve fizike.

Edhe sot janë miliona persona në botë, që i janë përkushtuar me devotshmëri stërvitjes së muskujve, në synimin e krijimit të trupit perfekt, me qëllim të përmirimit të gjendjes së tyre shëndetësore apo edhe për qëllime të arritjes së vlerave të caktuara sportive. Në botën moderne aktiviteti fizik shfrytëzohet jo vetëm si masë preventive por edhe si terapi shëruese për sëmundje të caktuara.

Edhe në vendin tonë në vitet e fundit ka një rritje bukur të mirë të interesimit të personave për tu marr me aktivitet fizik, në veçanti vërehet interesimi i tyre për të qenë vizitorë të rregullt të studiove të fitnesit. Çdo ditë e më shumë po hapen qendra sportive përkatësisht Fitness, si dhe rregullime të shtigjeve për vrapim në natyrë. Sipas OBSH (Organizata Botërore e Shëndetit) rekomandohet që njeriu gjatë ditës të lëvizë apo të ecë në ajër të pastër në natyrë së paku 30 min në ditë për shkak të efektit pozitiv që ka natyra në shëndetin e njeriut.

Përfitimet e aktivitetit të rregullt fizik për shëndetin e njeriut janë të dokumentuara nga shumë autorë të ndryshëm, sikurse përfshirja në çdo sport edhe të bërit e rregullt fitness i ka karakteristikat e veçanta që duhet marrë në konsideratë e sidomos kur bëhet fjalë për një shëndet më të mirë të njeriut. Megjithatë, pavarësisht përfitimeve të cilat vinë nga aktiviteti fizik shumë individ nuk angazhohen mjaftueshëm për përfitimet të cilat vinë si rezultat i aktivitetit fizik. Problemet me mbipeshën janë më se evidente edhe në vendin tonë si në vendet e huaja. Mbipesha dhe obeziteti janë përcaktuar si akumulim i tepruar i dhjavit që mund të dëmtojë shëndetin (ËHO, 2013). Për një përfshirje të rregullt në aktivitet fizik, faktorë kyç llogariten qëndrimet të cilat mbanë personi i caktuar ndaj aktivitetit fizik, dhe pikërisht këto qëndrime paraqesin edhe forcën kryesore motivuese.

Aktiviteti i rregullt fizik dhe ushqimi, pushimi i mirë pa dyshim se kontribuojnë në gjendjen e mirë shëndetsore dhe fizike tek njeriu. Fitnesi ka të bëjë me kondicionin fizik të trupit të njeriut e që me këtë të ndihet mirë në aspektin motorik dhe jep mundësitë e tij që t'i shfaq lëvizjet dhe t'i përfundojë pa ndonjë problem. Fitnesi aktivizon funksionimin e mirë të zemrës, mushkërive, muskulaturës, që këtë e bëjnë me lëvizje dhe me mendje e cila ndikon pozitivisht në stabilitetin emocional dhe mendor tek njeriu. Forma e mirë fizike, njeriut i mundëson që të ketë energjinë e nevojshme për plotësimin e aktiviteteve të përditshme jetësore si dhe për aktivitete tjera.

Fitnesi njihet si sport për të kalitur një trup të bukur dhe të shëndetshëm. Me zhvillimin e teknologjisë bashkëkohore ka ndikuar edhe zhvillimi i mjeteve-paisjeve për fitnes, të cilat kanë për qëllim ruajtjen e njerut nga lëndimet. Janë mjete më praktike, më funksionale e deri te ato më digjitale për harxhimin e kalorive. Sot fitnesi ka pushtuar botën, janë miliona njerëz në botë që i janë përkushtuar me devotshmeri stërvitjes së ëmbël të muskujve, të cilët kanë për synim krijim të trupit përfekt dhe pa ind dhjamor dhe të cilët janë në kërkim të rinisë së përvjetshme. Në ditët e sotme njeriu nga ana fizike dhe mendore është ngarkuar tej mase nga puna dhe jeta që e rrethon, andaj i duhet që vet të organizoj, planifikoj dhe të motivoj vetëveten për atë që është në interes të tij dhe të shoqërisë.

Të dhëna të shumta tregojnë se të qenit në formë fizike është qelësi i një jete të gjatë dhe të shëndetshme. Qysh në shekullin V para erës së re, mjekët e Greqisë së lashtë e dinin se ushtrimet fizike dhe ushqimi i mirë mundësojnë shëndet të mirë. (Qendra për Kontrollë dhe Parandalimin e Sëmundjes CDC). Hulumtimet e shumta tregojnë se aktiviteti i rregullt fizik zvogëlon rrezikun nga sëmundjet e rënda kronike, si sëmundja e zemrës, kanceri, diabeti, artriti, osteoporozja, obeziteti etj. Në një studim me mbi 39000 gra, që ka zgjatur 7 vite, është zbuluar se ecja prej një ore në javë, ka rezultuar me rrezik më të vogël të paraqitjeve të sëmundjeve të zemrës (Lee me bashkëpunor, 2001). Aktivitetet e rregullta fizike pengojnë shfaqjen e tensionit të lart të gjakut dhe e zvoglon atë. Madje të marrurit me aktivitete fizike iu ndihmon njerëzve të cilët kanë tension të lartë, pra përmirëson gjendjen e tyre shëndetësore. Sipas (Lee dhe Blair 2002) njerëzit që mirren me aktivitete fizike kanë më pak gjasa që të vdesin nga kanceri. Madje sipas (Shoqëria Amerikane e Kancerit 2002a) aktivitetet fizike zvoglojnë dhe parandalojnë shfaqjen e kancerit të gjirit dhe zorrës së trashë. Aktiviteti i rregullt fizik mund të ndihmojë në parandalimin e shfaqjes së diabetit të tipit 2, i

cili mund të shoqërohet me rrezik të madh nga kanceri i zorres se trashë dhe kanceri i pankreasit (Shoqeria Amerikane e Kancerit 2003a). Obeziteti (shëndoshja, trashja, dhjamosja), shoqërohet me rrezikun më të madh të shfaqjeve të sëmundjeve të ndryshme, për të mbajtur masën e trupit në vlera normale pa dyshim se faktori më i rëndësishëm është të marrurit më aktivitete fizike, fitnes, ecje, ciklizëm, ngjitje shkallëve, shfrytëzimi i shtigjeve natyrore etj, (Shoqeria Amerikane e Kancerit, 2003b). Pra siq është dokumentuar nga hulumtimet e shumta të cilat vinë nga përfitimi i të marrurit me fitnes, sport apo ndonjë aktivitet tjetër, i ka karakteristikat e veçanta që duhet marrur në konsideratë për një jetë me të shëndetshme. Si në vendet e tjera gjithashtu edhe në vendin tonë viteve të fundit ka një rritje bukur të mirë të intersimit për tu marrë me fitnes, duke u bazuar që viteve të fundit po hapen qendra të shumta për fitnes, kjo nëse mund të themi se është një vetëdijësim i mirë për personat që dëshirojnë të kenë një shëndet më të mirë. Numri i personave që merren me fitnes nuk është i njëjtë, çdo ditë apo çdo muaj ai ndryshon. Të marrurit me fitnes i ka përfitimet por edhe vështirësitë e veta. Kjo më ka ngjallë interesim që të hulumtoj këtë dukuri në komunwn time ku jetoj në Mitrovicë dhe të jap një shpjegim në lidhje më përfitimet dhe vështirësitë mes personve aktiv dhe atyre sedentar. Sipas OBSH (Organizata Botërore e Shendetësisë) rekomandohet që njeriu gjatë ditës të lëvizë, ecë apo të merret me ndonjë aktivitet sportiv të paktën 30 min për shkak të efektit pozitiv që ka lëvizja. Madje sipas (OBSH) mungesa e aktivitetit fizik është identifikuar si faktori i katërt kryesor i rrezikut për vdekshmëri globale.

Duke kuptuar se ushtirmi është mjet shumë i volitshëm për afirmimin dhe vlerat njerëzore, dhe është pjesë e jetës së njeriut për një shëndet më të mirë etj. Si në shumë vende të zhvilluara edhe në vendin tonë me disa aktivitete të ndryshme mundohen të promovojnë, zhvillojnë, organizojnë aktivitete fizike që kanë për qëllim vetëdijësimin e popullatës për benifitet që përfitojnë nga të marrurit me aktivitet fizik për një shëndet më të mirë. Megjithatë studiuesit theksojnë që as një herë nuk është vonë për të riparuar ose për t'i rikthyer disa funksione që kanë humbur (forca, qëndrueshmwria, fleksibiliteti etj).

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Hulumtime në fushën e fitnesit janë nga hulumtues të huaj dhe disa hulumtime nga vendi. Këto janë disa hulumtime që ndërlidhen me temën e cila trajton problematikën në aspektin kronologjik. Në shumë hulumtime të autorëve të huaj pyetëtori është shfrytëzuar për të hulumtuar nivelin e përceptimit të përfitimeve dhe për të identifikuar barrierat në të ushtruar në shumë kategori të njerëzve. Ka hulumtime të cilat kanë hulumtuar ndryshimet në mes të gjinive, në mes të personave aktive dhe sedentar, por ka edhe hulumtime të tipit longitudinal të cilat kanë hulumtuar ndryshimet në përceptim pas ndonjë tretmani të caktuar mjekësorë apo gjatë dhe pas kalimi të ndonjë faze të caktuar e cila sjellë ndryshime si rezultat i ndryshimit të gjendjes sic, janë situata gjatë dhe pas trajtimit mjekësor, faza gjatë dhe pas shtatzanisë etj. Në vendin tonë ka hulumtime të cilat i takojnë fushës së fitnesit por egziston mungesë e plotë e hulumtimit të ndërlidhjes së aspektve psikologjike, siq janë motivet dhe qëndrimet me te marrurit me aktivitet fizik. Nuk ka pasur hulumtime të mëhershme të cilat kanë shfrytëzuar si instrument hulumtues EBBS pyetësorin.

A.Gërvalla, F. Shahini.(Prishtinë 2011). Në punimin e tyre të Temës së Diplomimit- Master me temën “Fitnesi dhe Shëndeti” me moster 40 sportist të moshës 18-55 vjeç të dy gjinive të cilët kanë kryer dy matje, kanë vërtetuar se të gjithë ata që janë marrë me fitnes në fund të një programi 6 mujor të stërvitjes së rregullt ishin në një gjendje të përgjithshme shëndetsore më të mirë se në fillim të ushtrimeve. Si dhe kanë konstatuar se personat qe mirren me fitnes janë më aktiv, janë më të kënaqur me jetën e tyre dhe shëndeti i tyre është në një formë më të mirë.

Lovell, Ansarim & Parker (UK. 2010) Në një moster prej 200 studentëve në Angli të cilët duke përdorur pyetësorin “Ushtrime përfitimi/barrier e të marrurit me ushtrime” (Ebbs). Në hulumtimet e tyre kanë raportuar si përfitime më të mëdha në përceptimin nga të marrurit me ushtrime si: përfitime fizike, të ndjekura nga të mirat e opinionit psikologjik, shëndetësorë, parandalimin e sëmundjeve, zgjatje të jetës dhe ndërveprim social. Ndërsa pengesat më të mëdha ishin: lodhje fizike, marrje të kohës, ushtrimet e rënda dhe dekurajim i familjes etj.

Geoff P Lovell, Ęalid El Ansari and John K Parker (2012) kanë hulumtuar mostrën e 150 studentëve të cilët janë deklaruar si sedentarë dhe të cilët nuk bëjnë aktivitet te rregullt fizik. Edhe pse kanë qenë të deklaruar si persona të cilët bëjnë jetë sedentare përsëri vlerat përceptimit

të benefiteve nga te ushtruarit kanë qenë më të larta se perceptimi i barrierave të ushtruar. Këta persona benefitet më të larta i kanë parë në ngritjen e performancës fizike dhe në përfitime psikologjike nga të ushtruarit fizik.

Da Costa dhe Ireland K (2009) , studiuuan mostrën e 82 femrave dhe 90 meshkujve dhe gjetën se egzistonin dallime në mes gjinive sa i përket perceptimit të përfitimeve dhe barrierave për t' u marrë me ushtrime fizike. Meshkujt më shumë e ndërlidhin të ushtruarit me performancën fizike dhe dukjen trupore, përderisa tek femrat janë raportuar më shumë ndërlidhje me të percepturit e benefiteve nga ushtrimet në aspektin e socializimit, dhe rolit në përmirësimin e shëndetit.

Agnesa Rexha

3. KARAKTERISTIKAT ZHVILLIMORE TË VAJZAVE DHE MESHKUJVE TË MOSHES SË MESME SHKOLLORE

Adoleshenca si pikë fillimi e ka periudhën e pubertetit i cili shënon një periudhë të rritjes fizike të shpejtë nën shtytjen e hormoneve, që fillon tek vajzat rreth vitit të 11-të dhe te djemtë rreth vitit të 13-të (Bogin, 2011).

Adoleshenca si e tillë, një periudhë kalimtare mes të qenit fëmijë deri te të bërit i rritur, përfshin një periudhë mes 11 dhe 19 vjeç, sipas disave edhe deri 25 vjeç; gjatë së cilës personi përjeton jo vetëm rritje dhe ndryshim fizik, por edhe emocional, psikologjik, social dhe mental. Kjo periudhë është kategorizuar në tre stadi (Salmela-Aro, 2011):

- e hershme (11-13 vjeç);
- e mesme (13-17 vjeç) dhe
- e vonshme (17-19 vjeç).

Por ka dallime në literaturë për sa i përket këtyre kufijve kohor. Janë së paku 23 hormone në trupin e njeriut, që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e një adoleshenti, ku puberteti nis me një sinjal biokimik, që vjen nga ipotalamusi në gjëndrën pituitare, e cila më pas e aktivizon gjëndrën mbiveshkore, vezoret dhe testiset për të prodhuar hormonet seksuale (Bogin, 2011; Berger, 2009).

Në këtë zhvillim të vullshëm vinë në shprehje dhe atë dramatikisht karakteristikat e para gjinore-organet riprodhuese dhe gjenitalet e jashtme, të ndjekura edhe me karakteristikat e dyta gjinore që dallojnë sipas gjinive; trajtat jo-riprodhuese, si gjinjtë dhe ijet te femrat, qimet e fytyrës dhe thellimi i zërit tek djemtë, si dhe shenjat e njëjta për të dy gjinitë – dalja e qimeve në pjesën pubike dhe nënsqetulla edhe tek djemtë edhe tek vajzat (Bogin, 2011; Myers, 2013).

Nga kjo mund të përmblihet se fillimi i adoleshencës shënohet nga dy ndryshime sinjifikative në zhvillimin fizik (Shaffer & Kipp, 2010): së pari, forma dhe madhësia e tyre fizike (trupore) ndryshon dramatikisht, dhe së dyti, ato arrijnë në pubertet, një pikë jete kjo e pjekurisë seksuale dhe aftësisë për të riprodhuar (Pinyerd & Zipf, 2005).

Edhe zhvillimi i trurit në adoleshencë ka një rrjedhë karakteristike, dhe kalon nëpër disa ndryshime shumë sinjifikative, të cilat i mbështesin ndryshimet psiko-sociale që karakterizojnë këtë moshë. Deri në pubertet qelizat e trurit i shtojnë lidhjet e tyre, dhe pastaj në adoleshencë

ndodhë një krasitje selektive e neuroneve dhe lidhjeve të pashfrytëzuara (Blakemore, 2008). Llogariten se humbin rreth 30.000 sinapsa për sekondë gjatë adoleshencës (Rakic, Bourgeois, & Goldman-Rakic, 1994). Të humburit e gati gjysmës së lidhjeve sinaptike të kores së trurit që ishin prezent para pubertetit - besohet se i prek së pari sinapsat ekscitatore dhe shoqërohet me një rënie në metabolizmin e glukozës në tru, në uljen e shfrytëzimit të oksigjenit dhe rrjedhës së gjakut etj.; kështu që pasojat e këtij rimodelimi janë sidomos prezente në korteksin prefrontal (Martin & Volkmar, 2007). Kjo padyshim se ndikon edhe në realizimin e detyrave lëvizore dhe se në aspektin e rezultateve sportive vërejmë një rrënje të performancës lëvizore.

Si përfundim i adoleshencës në aspektin e zhvillimit fizik llogariten:

1. ndërprerja e rritjes skeletore në gjatësi, për shkak të mbylljes së epifizave të eshtrave të gjata;
2. kompletimi i zhvillimit të dhëmbëve si dhe
3. pjekuria sociale-seksuale që ka kuptimin e aftësisë biologjike dhe sociale për prindërim të suksesshëm (Bogin, 2011) .

Rritja dhe pjekuria fizike zakonisht kompletohen për një periudhë kohore deri në 4 vite pas shfaqjes së shenjave të para, ndonëse në vitet e fundit të adoleshencës dhe herët në të njëzetat disa individë shtojnë ende lartësinë dhe shumë të tjerë edhe dhjam e muskuj në trup (Berger, 2009).

Ashtërimi te femrat bëhet më shpejt se sa te meshkujt. Tempoja e rritjes së dimensioneve cirkulare është më e vogël në krahasimin me rritjen e dimensioneve longitudinal, kështu që trupi fiton pamjen e papëlqyer. Ndryshimi në ndërtimin e skeletit mes gjinive është i theksuar . Rritja më intensive te femrat është në moshën 11 – vjeçare, kurse te djemtë në moshën 13-14 vjeçare. Për shkak të rritjes së hovshme të eshtrave dhe mungesës së ashtërimit adekuat dhe ngecja në zhvillimin e sistemit muskular, te fëmijet e kesaj moshe shumë lehtë mund të vijë deri te deformimet trupor dhe të mbajturit e dobët të trupit drejt. Posaqërisht është i ndjeshëm skeleti, unazat vertebrale dhe shtylla kurrizore. Për këtë shkak eshtrat janë të dobët dhe të ndjeshëm në rënie. Për shkak të rritjes së hovshme të eshtrave të gjatë dhe njëkosisht pamundësisë së muskujve që ti përcjellin, vjen deri te zgjatja e tyre çka shkakton tonusin e lartë. Aftësitë motorike mund të manifestohen vetëm me aktivitete të lëvizshme të cilat më së shumti varen nga struktura morfologjike. Efikasiteti motorik i njeriut varet nga rregullimi i mekanizmave qëndrore

dhe efektorëve të njësive periferike. Pasi që disa karakteristika të nënsistemit periferik mund të vërtetohen në bazë të parametrave (matjeve) antropometrikë , vërtetimin e relacioneve ndërmjet aftësive motorike dhe karakteristikave morfologjike e kanë studiuar shumë shkenctarë, të cilët kanë konstatuar se në efikasitetin motorik ka ndikuar variabiliteti i karakteristikave morfologjike . Hulmutimet shkencore për përcaktimin e strukturës morfologjike janë vërtetuar me ca matje antropometrike (parametra antropometrikë), kurse efikasiteti motorik është përcaktuar në bazë të rezultateve të disiplinave sportive. Ky lloj tipi i hulmutimit ose drejtim hulmutimi ka dhënë argumente të mira dhe të dobishme për seleksionim të sportistëve, kurse nga aspekti shkencor informatat janë të pamjaftueshme mbi njohjen shkencore të thellë të ndikimit morfologjik në efikasitetin motorik.

4. NDIKIMI I AKTIVITETEVE FIZIKE NË ORGANIZMIN E NJERIUT

Ndikimi i aktivitetit fizik në organizmin e njeriut bazohet në adaptimin morfologjik dhe funksional, si dhe në ekonomizimin e funksionëve të caktuara. Aktivitetet e rregullta fizike ndikojnë në tërë organizmin e njeriut: (në muskuj, eshtra, sistem nervor, vegjetativ, frymëkëmbim, sistem endokrin, sistem kardiovaskular, në lëngjet trupore, në qarkullimin, përbërjen dhe koncentrimin e gjakut). Gjatë aktivitetit fizik rritet koncentrimi i materieve osmotikisht aktive në plazmë, gjë që ndikon në rritjen e shtypjes koloido-osmotike të gjakut. Gjatë tërë kohës së aktivitetit fizik, në indet joaktive të trupit bëhet zvoglimi i shtypjes hidrostatike, rritja e shtypjes koloido-osmotike, rritja e procesit të absorbimit në kapilarë dhe si rezultat zvoglohet sasia e ujit në këto inde joaktive. Në këtë mënyrë, fuqizohet procesi i absorbimit të ujit nga këto inde në kapilarë dhe shtohet qarkullimi i gjakut për 500 ml. Nëse vazhdon puna e rëndë muskulare, humbja e ujit përmes djersitjes mund të arrihet deri në 2 litra në orë. Mos kompensimi me kohë i lëngjëve të humbura ndikon në dehidrimin e organizmit, zvoglimin e pakompensueshëm të vëllimit të gjakut qarkullues, në zvoglimin e vëllimit minutor të zemrës dhe në rritjen e frekuencës së zemrës mbi vlerat normale.

Rritja e numrit të eritrocidëve, te sportistët, bën që të shtohet edhe sasia e hemoglobinës në qarkullim, gjë që ndihmon oksigjenimin më të mirë të indeve. Aktivitetet fizike intenzive, kohëshkurta dhe kohëzgjatja, kontinuale dhe diskontinuale, ndikojnë në rritjen e koncentrimin të leukociteve. Pas përfundimit të aktivitetit fizik, kthimi i vlerave të leukociteve në vlerat e gjendjes së pushimit bëhet varësisht nga kohëzgjatja e aktivitetit. Në përgjithësi, sportistët janë më të ndjeshëm në ftohje dhe në inflamacionet e fytyrës, ndërsa rrezikshmëria nga sëmundjet malinje është më e vogël, krahasuar me josporistët. Të gjitha lëvizjet, qofshin ato në formë të ushtrimeve trupore, të programuar, stërvitjeve për gara sportive, apo në formë të lëvizjeve rekreative, kanë ndikim në shëndet – organizmin e njeriut, respektivisht në aftësitë punuese, e kjo varet nga:

- **Intenziteti**
- **Frekuenca**
- **Kohëzgjatja e tyre**

5. METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij hulumtimi i përket hulumtimit të natyrës kuantitative. Për realizimin e punimit praktik është përdorur instrumenti i standardizuar (pyetsori) i prodhuar nga **Sechrist, Karen R.; Ealker, Susan N.; Pender, Nola J.** në Universitetin e Michiganit, në vitin 1987. Me anë të këtij instrumenti është arrit të vërtetohet ndryshimi në shkallën e perceptimit të përfitimeve/barierave nga të marrurit me ushtrime të rregullta në fitnes ndërmjet personave aktiv dhe atyre sedentar (jo aktiv). Zhvillimi i instrumentit Përfitimet e stërvitjes / Barrierat (EBBS) është zhvilluar si përgjigje ndaj nevojës për një instrument për të përcaktuar perceptimet e individëve në lidhje me përfitimet dhe barrierat për pjesëmarrje në stërvitje. Instrumenti që përdorë është testuar për konsistencë, të brendshëm, vlefshmërinë e pyetjeve të pyetësorit si dhe besueshmërinë test-retest.

5.1. QËLLIMI

Qëllimi kryesor i hulumtimit është të provohet pyetëtori i standardizuar i cili mat ndryshimet që kanë të bëjnë me perceptimin e përfitimeve dhe barrierave në procesin e të ushtruarit. Ky pyetësorë përkundër që është i standardizuar do të provohet në mostër nga Kosova dhe atë me të dyja gjinitë për të parë se sa mund të bëjë diferencimin në mes të dy kategorive të ndryshme. Qëllim tjetër i këtij studimi është të krahasohet shkalla e perceptimit në përfitimet dhe pengesat nga të marrurit me ushtrime të fitnesit në mes të personave aktiv në fitnes, që mund të jenë studentë, punëtor etj dhe nxënës të shkollës së mesme të cilët nuk janë aktiv në procesin e të ushtruarit.

Po ashtu qëllim në vete është që të vërtetohen edhe qëndrimet të cilat i mbajnë nxënësit e shkollës së mesme ndaj përfshirjes së rregullt të tyre në procesin stërvitor, me theks të veçantë në gjetjen e arsytimit të cilat do i paraqesin nxënësit për mosaktivitetin e tyre fizik.

Objektiva specifike të hulumtimit janë:

- Vërtetimin e dallimit në shkallën e perceptimit të përfitimeve te personat aktive dhe pasiv të gjinisë femërore.
- Vërtetimin e dallimit në shkallën e perceptimit të përfitimeve te personat aktiv dhe pasiv të gjinisë mashkullore.
- Vërtetimin e shkallës së perceptimit të barrierave më të larta nga sedentarët.

5.2. PYETJET HULUMTUESE

Për të vendosur hipotezat e hulumtimit jemi shërbyer me pyetjet të cilat i kanë paraprirë ndërtimit të hipotezave hulumtuese. Pyetjet e hulumtimit përveç që kanë lindur nga trajtimi i literaturës e cila kryesisht ka të bëjë me qëndrimet e personave të kategorive të ndryshme ndaj ushtrimit të rregullt, si shtytje tjetër kanë pasur edhe faktin e punës time si instruktore personale për personat të cilët kanë qenë aktiv në të ushtuar. Nisur nga kjo kam vërejtur se pjesa më e rëndësishme në procesin stërvitorë është krijimi i shprehive për të ushtruarit e rregullt, e që procesi i krijimit të shprehive është i lidhur me ndryshimin e qëndrimeve të cilin personat e caktuar e kanë në lidhje me çështje të caktuara.

Pyetjet hulumtuese:

Realizimit të këtij hulumtimi i kanë paraprirë këto pyetje:

- 1. A ka dallime sa i përket vlerës që ka aktiviteti i rregullt fizik në mes të nxënësve të shkollave të mesme të gjinisë femërore të cilët rregullisht merren me aktivitet fizik (Fitnes) dhe atyre të cilët nuk merren në mënyrë aktive.**
- 2. A ka dallime sa i përket vlerës që ka aktiviteti i rregullt fizik në mes të nxënësve të shkollave të mesme të gjinisë mashkullore të cilët rregullisht merren me aktivitet fizik (Fitnes) dhe atyre të cilët nuk merren në mënyrë aktive.**
- 3. A ka dallime sa i përket vlerës që ka aktiviteti i rregullt fizik në mes të nxënësve të shkollave të mesme në mes të dy gjinive të cilët rregullisht merren me aktivitet fizik (Fitnes) dhe atyre të cilët nuk merren në mënyrë aktive.**
- 4. A janë këto dallime rezultat i arsytimeve të cilat kategoria e caktuar i bën duke i përshkruar si ndikim i faktorëve të jashtëm.**

5.3. HIPOTEZAT

Nga pyetjet e dala dhe logjika e gjetjeve të hulumtimve të mëparshme kam ngritur këto hipoteza të cilat kam pritur se do të vërtetohen:

H1 - Nxënësit e shkollave të mesme, të gjinisë femërore, të cilët janë aktiv do të tregojnë vlera më të larta të vlerësimit të rëndësisë së aktivitetit fizik në krahasim me personat të cilët nuk janë aktiv.

H2 - Nxënësit e shkollave të mesme, të gjinisë mashkullore, të cilët janë aktiv do të tregojnë vlera më të larta të vlerësimit të rëndësisë së aktivitetit fizik në krahasim me personat të cilët nuk janë aktiv.

H4- Nuk do të ketë dallime në mes të gjinive të dy grupeve sa i përket qëndrimeve ndaj aktivitetit fizik.

H4 - Nxënësit jo aktiv do të jenë më të pirur që të justifikojnë mos aktivitetin e tyre duke u arsyetuar në ndikimin e faktorëve të jashtëm.

5.4. MOSTRA E HULUMTIMIT

Në këtë hulumtim është trajtuar popullata e nxënësve të moshës 15 -18 vjecare, nxënës të shkollës së mesme, vijues të shkollave në komunën e Mitrovicës nga vendbanimet urbane dhe ato rurale. Në qytetin e Mitrovicës numri i personave që mirren me fitnes dhe të cilët janë aktivisht të përfshirë në klubet sportive është në nivel të lartë, mirëpo ky numër ndryshon gjatë muajve dhe stinëve. Në mostrën e këtijë hulumtimi janë të përfshirëj **150 persona aktiv**, përkatsisht 75 meshkuj dhe 75 femra aktive (mbi 1 vit aktiv) dhe **150 persona sedentar**, prej tyre 75 janë të gjinisë mashkullore dhe 75 të gjinisë femërore të cilë me vetë dëshirë e kanë quajtur vetën sedentar (jo aktiv). Personat aktiv janë cilësuar ata të cilët në mënyrë aktive janë të përfshi në fitnes apo janë pjesatar të ndonjërit nga klubet sprotive të cilat janë aktive në Komunën e Mitrovicës. Pra në mostër janë të përfshirë gjithsej 300 persona (150 aktiv dhe 150 pasiv) . Mbledhja e të dhënave është bërë gjatë gjysëmvjetorit të dytë të mësimit në mes të muajve Mars- Maj të vitit 2017.

5.5. INSTRUMENTI DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Në këtë hulumtim instrumenti për mbledhjen e të dhënave me qëllim të përcaktimit të shklës e të përfitimeve të marrurit me fitnes në mes të personave aktiv dhe nxënësve të shkollës së mesme te cilët llogariten si popullatë sedentare është përdorur pyetësi i standardizuar "The Exercise Benefits/Barreires Scale" (EBBS) i cili në Gjuhën Shqipe përkthehet si "Shkalla e matjes/përceptimit të pwrfitimeve/barrierës nga ushtrimet" e prodhuar nga **Sechrist, KR, Ëalker, SN, & Pender, NJ. (1987)**. Ky pyetësor fillimisht është përdorur në fushën e infermierisë për të identifikuar motivet dhe pengesat e pacientëve në process të rehabilitimit e më vonë është modifikuar edhe për nevoja të hulumtimeve me persona të shëndoshë.

Gjatë plotësimit të pyetësit fillimisht janë njoftuar apo ju është dhënë informata për qëllimin dhe rëndësin që ka ky hulumtim, që të gjithëve si personave aktiv dhe atyre sedentar (pasiv), mandej ju është shpërndar pyetësi. Vlenë të theksohet se plotwsimi i pyetësit për personat aktiv është bërë në qendra të fitnesit përkatwsisht në qendrën e fitnesit në Elite Gym (80%) dhe Hoist Gym (20%) duke i përmbushur kriterit e lartwcekura. Ndërsa për personat sedentar plotwsimi i pyetsorit është bërë në Shkollën e Mesme „ Gjimanzi Frang Bardhe” në qytetin e Mitrovicës.

Pyetësi përbëhet prej 43 pyetje të cilat janë të ndarë në dy komponente: Përfitimet dhe Pengesat. Komponenti i përfitimeve është i përbërë prej 29 pyetjeve, ndërsa komponenti i pengesave është i përbërë prej 14 pyetjeve.

| PËRFITIMET | PENGESAT |
|---|---|
| Pëceptimi i përfitimeve për ushtrime (29 pyetje) | Pëceptimi i pengesave për ushtrime (14 pyetje) |
| Përmisim të jetës (8 pyetje) | Ushtrime të rënda (6 pyetje) |
| Performanc fizike (8 pyetje) | Shpenzim kohe (3 pyetje) |
| Përceptim psikologjik (6 pyetje) | Ngarkes fizike (3 pyetje) |
| Bashkveprim shoqëror (4 pyetje) | Dekurajim familjar (2 pyetje) |
| Parandalim sëmundjes (3 pyetje) | |

Tab. 1 . Komponentet e pyetësit EBBS

Për secilën pyetje të anketuarit kanë pasur katër opsione për të zgjedhur:

1. Plotësisht pajtohem – Aprovimi i plotë.
2. Pajtohem – Tregon shkallë të aprovimit por diçka më të ulët se e para.
3. Nuk pajtohem – Shprehë kundërshtim të asaj që thuhet.
4. Plotësisht nuk pajtohem – Shpreh kundërshtim kategorik.

Përceptimi i përfitimeve për ushtrime (29)

Përmirësimi i jetës (8)

| | |
|----|---|
| 25 | Rregullimi im është përmirësuar me ushtrime |
| 26 | Ushtrimet më ndihmojnë të fle më mirë gjatë natës |
| 29 | Ushtrimet më ndihmojnë të çlodhem (zvogëloj lodhjen) |
| 32 | Ushtrimet përmirësojnë vetë-vlersimin tim |
| 34 | Ushtrimi rrit vigjilencën time mendore |
| 35 | Ushtrimet më mundësojnë të kryej aktivitete normale pa u ndier i lodhur |
| 36 | Ushtrimet e përmirësojnë cilësinë e punës sime |
| 41 | Ushtrimet përmirësojnë funksionalitetin e tërësishëm të trupit tim |

Performancë fizike (8)

| | |
|----|--|
| 7 | Ushtrimet e rrisin forcën time muskulare |
| 15 | Ushtrimi i rregullt rrit nivelin tim të përgaditjes fizike |
| 17 | Tonusi im muskularë është përmirësuar me ushtrime |
| 18 | Ushtrimi përmirëson funksionimin e sistemit tim kardiovaskular |
| 22 | Ushtrimi rrit qëndrueshmërinë time |
| 23 | Ushtrimi përmirëson fleksibilitetin tim |
| 31 | Qëndrueshmëria ime fizike është përmirësuar duke ushtruar |
| 43 | Ushtrimet e përmirësojnë dukjen e trupit tim |

Përceptim psikologjik (6)

| | |
|----|--|
| 1 | Mua më pëlqen të ushtroj |
| 2 | Ushtrimi më zvogelon ndjenjat e stresit dhe tensionit |
| 3 | Ushtrimi e përmirëson shëndetin tim mendorë |
| 8 | Ushtrimet më japin ndjenjën e arritjes personale |
| 10 | Ushtrimet më bëjnë të ndjehem i relaksuar |
| 20 | Me anë të ushtrimeve më është përmirësuar ndjenja e mirëqenies personale |

Bashkëveprim shoqëror (4)

| | |
|----|--|
| 11 | Ushtrimet më mundsojnë të kem kontakt me miqtë dhe personat që më pëlqejnë |
| 30 | Ushtrimi është një mënyrë e mirë për të takuar njerz të rinjë |
| 38 | Ushtrimi është argëtim i mirë për mua |
| 39 | Ushtrimi rrit provueshmërinë time nga të tjerët |

Parandalim të smundjes (3)

| | |
|----|---|
| 5 | Duke ushtruar rregullisht do të parandalojë sulmet e zemrës |
| 13 | Të ushtruarit më ruan nga presioni i lartë i gjakut |
| 27 | Nëse ushtroj rregullisht, do të jetojë më gjatë |

Përceptim i pengesave (14)

Ushtrime të rënda (6)

| | |
|----|--|
| 9 | Vendet për të ushtruar janë shumë larg për mua |
| 12 | Unë jam shumë i sikletosur kur duhet të ushtroj |
| 14 | Marrja me ushtrime është shumë e kushtueshme |
| 16 | Oraret e punës të palestarve të ushtrimeve nuk janë të përshtashme për mua |
| 28 | Unë mendojë se njerëzit me veshje sportive duken qesharak |
| 42 | Për mua ka shumë pak vende për të ushtruar |

Shpenzim kohe (3)

| | |
|----|---|
| 4 | Ushtrimet më marrin shumë kohë |
| 24 | Ushtrimi më merr shumë kohë nga marrëdhëniet familjare |
| 37 | Ushtrimet marrin shumë kohë nga përgjegjësitë e mia familjare |

Ngarkes fizike (3)

| | |
|----|-------------------------------------|
| 6 | Ushtrimet më lodhin mua |
| 19 | Unë jam i lodhur nga ushtrimi |
| 40 | Ushtrimi është punë e rëndë për mua |

Dekurajim familjar (2)

| | |
|----|--|
| 21 | Bashkëshorti im (partneri), nuk më inkurajon për të ushtruar |
| 33 | Familjarët e mi nuk më inkurajojnë mua për të ushtruar |

5.6. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE

Për përpunimin e të dhënave në këtë hulumtim është përdorur programi kompjuterik SPSS version 20. Me qëllim të fitimit të një pasqyre sa më të qartë të gjendjes do të aplikohen metoda statistikore të cilat i ndihmojnë përmbushjes së hipotezave të parashtruar.

Për përshkrim të grumbullimit dhe shpërndarjes së rezultateve si dhe relacioneve korrelative të cilat egzistojnë në mes të grupeve do të aplikohet metoda standarde të analizës deskriptive (përshkruese) statistikore.

Mean - meseri aritmetik,

Min - rezultati minimal,

Max - rezultati maksimal,

Std.Dev. - devijimi standard,

St.error - gabimi standard i mesatares aritmetikore,

Me qëllim të nxjerrejs së konkludimeve për dallimet e domethënëse statistikore janë përdorur dy metoda standarde.

T – testi – Për përcaktimin e rëndësisë statistikore

6. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

6.1. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR - GRUPI I MESHKUVJE AKTIV

Në tabelën nr. 2 janë paraqitur vlerat e parametrave themelor statistikor ku janë analizuar vlera e tendencës qvndrore e rezultateve si dhe metodat e shpërndarjes së rezultateve rreth mesatares së tyre aritmetike te grupi i meshkujve të cilët në mënyrë aktive merren me fitnes. Në kuadër të analizës së këtyre tabelave vlenë të theksohet se në pjesën më të madhe të variablave, janë realizuar vlera mesatare të cilat tregojnë se mesatarja e rezultateve të të gjitha pyetjet të cilat shprehin qëndrim pozitiv ndaj të ushtruarit është mjaft e lartë, e që në shumicën e rasteve është afër vlerës 4. Vlerat më të larta vërehen tek pyetjet të cilat kanë të bëjnë me faktin se personave të cilët janë aktiv ju pëlqen të ushtrojnë, këtu mesatarja e të gjitha përgjigjeve është 3.87. Vlera më e lartë e mesatarës aritmetike të ky grup vërehet në deklarin e tyre se: "Ushtrimet e përmirësojnë dukjen e tyre trupore". Vlera e mesatarës aritmetike në këtë rast është 3.92. Nga përgjigjet e këtyre personave vërehet se këtë e kanë të qartë se të ushtruarit ndikon mirë në rritjen e performancës fizike, në të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e forcës muskulore, qëndrueshmërisë 3.84 dhe rritjes së funksionalitetit. Po ashtu janë paraqitur vlera të larta të vlerave mesatare në të gjitha përgjigjet ku është vlerësuar rëndësia e ushtrimit në përmirësimin e ndjenjës personale si dhe në ngritjen e vetëvlerësimit. Mesatare të ulëta janë realizuar në të gjitha ato pyetje të cilat kanë shprehur qëndrim kundërshtues ndaj të ushtruarit të rregullt, siç janë pyetjet e tilla si: "Ushtrimet më lodhin", "Ushtrimet kanë kosto të lartë", "Vendushtrimet nuk gjenden në lokacion të përshtatshëm", "Oraret nuk përshtaten me obligimet dhe agjendën".

Vlera më të ulta që sillen rreth 1.60 janë paraqitur në deklarin e tyre si: "Ushtrimet janë punë të rënda për mua", se orari i punës së palestrave është i papërshtatshëm për ta si dhe koha të cilën e marrin ushtrimet e rregullta. Të gjitha këto tregojnë se personat aktiv nuk janë të prirur të gjejnë arsyetim por janë të vetëdijshëm për vlerën e ushtrimeve dhe evitojnë çdo gjë që mund të duket si pengesë për ta.

| Statusi i te marrurit me aktivitet = Meshkuj Aktiv ne Fitnes | | | | | | | | |
|--|---|------|------|--------|------|----------|-----|-----|
| Nr. | Pyetje | N | Mean | Median | Mode | Std. Dev | Min | Max |
| | | Vali | | | | | | |
| 1 | Mua më pëlqen të ushtrtoj. | 75 | 3.87 | 4.00 | 4 | .342 | 3 | 4 |
| 2 | Ushtrimi më zvogëlon ndjenjat e stresit dhe tensionit. | 75 | 3.41 | 3.00 | 3 | .496 | 3 | 4 |
| 3 | Ushtrimi e përmirëson shëndetin tim mendorë. | 75 | 3.63 | 4.00 | 4 | .487 | 3 | 4 |
| 4 | Ushtrimet më marrin shumë kohë. | 75 | 1.71 | 2.00 | 2 | .712 | 1 | 4 |
| 5 | Duke ushtruar rregullisht do të parandaloj sulmet e zemrës. | 75 | 3.16 | 3.00 | 3 | .679 | 1 | 4 |
| 6 | Ushtrimet me lodhin mua. | 75 | 2.09 | 2.00 | 2 | .738 | 1 | 4 |
| 7 | Ushtrimet e rrisin forcën time muskulore. | 75 | 3.71 | 4.00 | 4 | .458 | 3 | 4 |
| 8 | Ushtrimet më japin ndjenjën e arritjes personale. | 75 | 3.35 | 3.00 | 4 | .668 | 2 | 4 |
| 9 | Vendet për të ushtruar janë shumë larg për mua. | 75 | 2.00 | 2.00 | 2 | .900 | 1 | 4 |
| 10 | Ushtrimet më bëjnë të ndihem i relaksuar | 75 | 3.61 | 4.00 | 4 | .490 | 3 | 4 |
| 11 | Ushtrimet më mundësojnë të kem kontakt me miqtë dhe personat qe | 75 | 3.24 | 3.00 | 3 | .768 | 1 | 4 |
| 12 | Unë jam shumë i sikletosur kur duhet të ushtrtoj. | 75 | 1.77 | 2.00 | 2 | .559 | 1 | 3 |
| 13 | Të ushtruarit të më ruan nga presioni i lartë i gjakut. | 75 | 3.21 | 3.00 | 3 | .444 | 2 | 4 |
| 14 | Marrja me ushtrime është shumë e kushtueshme. | 75 | 3.11 | 3.00 | 3 | .879 | 1 | 4 |
| 15 | Ushtrimi i rregullt rrit nivelin tim të përgatitjes fizike. | 75 | 3.73 | 4.00 | 4 | .622 | 1 | 4 |
| 16 | Oraret e punës të palestrave të ushtrimeve nuk janë të përshtatshme | 75 | 1.63 | 2.00 | 1 | .731 | 1 | 4 |
| 17 | Tonusi im muskolor është përmirësuar me ushtrim. | 75 | 3.43 | 4.00 | 4 | .720 | 1 | 4 |
| 18 | Ushtrimi përmirëson funksionimin e sistemit tim kardiovaskular. | 75 | 3.28 | 3.00 | 3 | .669 | 1 | 4 |
| 19 | Unë jam i lodhur nga ushtrimi. | 75 | 1.91 | 2.00 | 2 | .903 | 1 | 4 |
| 20 | Me anë të ushtrimeve më është përmirësuar ndjenjat e mirëqenies | 75 | 3.05 | 3.00 | 3 | .634 | 1 | 4 |
| 21 | Bashkëshorti im (Partneri), nuk me inkurajojnë për të ushtruar. | 75 | 2.00 | 2.00 | 2 | 1.027 | 1 | 4 |
| 22 | Ushtrimi rrit qëndrueshmëri tim. | 75 | 3.60 | 4.00 | 4 | .493 | 3 | 4 |
| 23 | Ushtrimi përmirëson fleksibilitet tim. | 75 | 3.35 | 3.00 | 3 | .626 | 1 | 4 |
| 24 | Ushtrimi më merr shumë kohë nga marrëdhëniet familjare. | 75 | 2.17 | 2.00 | 2 | .950 | 1 | 4 |
| 25 | Rregullimi ime është përmirësuar me ushtrim. | 75 | 3.48 | 4.00 | 4 | .644 | 2 | 4 |
| 26 | Ushtrimet më ndihmojnë të fle më mirë gjatë natës. | 75 | 3.39 | 3.00 | 4 | .733 | 1 | 4 |
| 27 | Nëse ushtrroj rregullisht, do të jetojnë më gjatë. | 75 | 3.11 | 3.00 | 3 | .798 | 1 | 4 |
| 28 | Unë mendoj se njerëzit në veshje sportive duken qesharak. | 75 | 1.85 | 2.00 | 1 | 1.023 | 1 | 4 |
| 29 | Ushtrimet me ndihmojnë të çlodhem (zvogëloj lodhjen). | 75 | 3.44 | 4.00 | 4 | .683 | 1 | 4 |
| 30 | Ushtrimi është një mënyrë e mirë për të takuar njerëz të rinj. | 75 | 3.01 | 3.00 | 3 | .780 | 1 | 4 |
| 31 | Qëndrueshmëria ime fizike është përmirësuar duke ushtruar. | 75 | 3.84 | 4.00 | 4 | .369 | 3 | 4 |
| 32 | Ushtrimet përmirësojnë vetë-vlerësimin tim. | 75 | 3.23 | 3.00 | 3 | .628 | 1 | 4 |
| 33 | Familjarët e mi nuk me inkurajojnë mua për të ushtruar. | 75 | 2.16 | 2.00 | 1 | 1.186 | 1 | 4 |
| 34 | Ushtrimi rrit vigjilencë time mendore. | 75 | 3.23 | 3.00 | 3 | .689 | 1 | 4 |
| 35 | Ushtrimet më mundësojnë të kryej aktivitetet normale pa u ndier i | 74 | 3.65 | 3.00 | 3 | 0.696 | 2 | 4 |
| 36 | Ushtrimet përmirësojnë cilësinë e punës sime. | 75 | 3.07 | 3.00 | 3 | .777 | 1 | 4 |
| 37 | Ushtrimet marrin shumë kohë nga përgjegjësitë e mia familjare. | 75 | 2.01 | 2.00 | 2 | 1.020 | 1 | 4 |
| 38 | Ushtrimi është argëtim i mirë për mua. | 75 | 3.53 | 4.00 | 4 | .577 | 2 | 4 |
| 39 | Ushtrimi rrit provueshmërinë time nga të tjerët. | 75 | 2.84 | 3.00 | 2 | .839 | 1 | 4 |
| 40 | Ushtrimi është punë e rëndë për mua. | 75 | 1.64 | 1.00 | 1 | .864 | 1 | 4 |
| 41 | Ushtrimet e përmirësojnë funksionalitetin e tërësishëm të trupit tim. | 75 | 3.21 | 3.00 | 3 | .776 | 1 | 4 |
| 42 | Për mua ka shumë pak vende për të ushtruar. | 75 | 2.15 | 2.00 | 2 | .996 | 1 | 4 |
| 43 | Ushtrimet e përmirësojnë dukjen e trupit tim. | 75 | 3.92 | 4.00 | 4 | .273 | 3 | 4 |

Tab. 2 . Parametrat themelor statistikore të personave meshkuj aktiv

6.2. INTERPRETIMI I PARAMETRAVE THEMELOR STATISTIKOR GRUPI I MESHKUVJE PASIV NË FITNES

Në tabelën Nr. 3 janë paraqitur vlerat e parametrave themelor statistikor ku janë analizuar vlerat e tendencës qendrore e rezultateve si dhe metodat e shpërndarjes së rezultateve rreth mesatares së tyre aritmetike për grupin e personave të cilët nuk merren në mënyrë aktive me fitnes. Nga rezultatet e tabelës vlenë të theksohet se në pjesën më të madhe të variablave janë realizuar vlera mesatare të cilat tregojnë se mesatarja e rezultateve të të gjitha pyetjet të cilat shprehin qëndrim pozitiv ndaj të ushtruarit është mesatarisht e lartë, e që në shumicën e rasteve e kalon vlerën mesatare mbi 3. Nëse e bëjmë një krahasim të rezultateve të këtij grupi me grupin e personave aktiv atëherë në të gjitha rastet vërejmë vlera më të ulta të mesatarës aritmetike në përgjigjet në pyetjet pohuese, dhe vlera më të lartë të mesatarës aritmetike tek përgjigjet mohuese ndaj të ushtruarit fizik. Si shembull mund të krahasojmë disa vlera në disa pyetje më specifike si në rastin e personave të cilët janë aktiv ju pëlqen të ushtrojnë, këtu mesatarja e të gjitha përgjigjeve është 3.87. ndërsa te personat sedentarë kjo vlerë është 3.47. Edhe në këtë rast vlera më e lartë është te pyetja mua më pëlqen të ushtroj e cila është 3.47.

Në përgjigjet e personave aktiv vërehet se këtë e kanë të qartë se të ushtruarit ndikon mirë në rritjen e performancës fizike, në të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e forcës muskulore, qëndrueshmërisë dhe rritjes së funksionalitetit vlera mesatare është nga 3.62 deri në 3.80, ndërsa tek grupi sedentarë këto vlera sillen nga 2.96 deri në 3.30. Po ashtu janë paraqitur vlera të larta, por më të ulta se në grupin aktiv, të vlerave mesatare në të gjitha përgjigjet ku është vlerësuar rëndësia e ushtrimit në përmirësimin e ndjenjës personale si dhe në ngritjen e vetëvlerësimit. Mesatare të larta tek grupi sedentarë gjejmë zakonisht ato pyetje të cilat kanë shprehur qëndrim kundërshtues ndaj të ushtruarit të rregullt, siç janë pyetjet e tilla si: "Ushtrimet më lodhin", "Ushtrimet kanë kosto të lartë", "Vendushtrimet nuk gjenden në lokacion të përshtatshëm", "Oraret nuk përshatën me obligimet dhe agjendën", në të gjitha këto raste mesataret aritmetike tregojnë.

Nga e gjithë tabela mund të konkludohet se vërehen dallime të lehta të cilat mund të testohen më vonë për rëndësinë e ndryshimeve e cila egziston në mes të grupeve.

| Statusi i te marrurit me aktivitet = Meshkuj Pasiv ne Fitnes | | | | | | | | |
|--|---|------|------|--------|------|----------|-----|-----|
| Nr. | Pyetje | N | Mean | Median | Mode | Std. Dev | Min | Max |
| | | Vali | | | | | | |
| 1 | Mua më pëlqen të ushtruj. | 75 | 3.47 | 4.00 | 4 | .827 | 1 | 4 |
| 2 | Ushtrimi më zvogëlon ndjenjat e stresit dhe tensionit. | 75 | 3.33 | 4.00 | 4 | .794 | 1 | 4 |
| 3 | Ushtrimi e përmirëson shëndetin tim mendorë. | 75 | 3.17 | 3.00 | 3 | .828 | 1 | 4 |
| 4 | Ushtrimet më marrin shumë kohë. | 75 | 2.65 | 3.00 | 2 | .908 | 1 | 4 |
| 5 | Duke ushtruar rregullisht do të parandaloj sulmet e zemrës. | 75 | 2.68 | 3.00 | 3 | .857 | 1 | 4 |
| 6 | Ushtrimet me lodhin mua. | 75 | 2.72 | 3.00 | 3 | .966 | 1 | 4 |
| 7 | Ushtrimet e rrisin forcën time muskulore. | 75 | 2.96 | 3.00 | 2 | .907 | 2 | 4 |
| 8 | Ushtrimet më japin ndjenjën e arritjes personale. | 75 | 2.93 | 3.00 | 4 | .905 | 1 | 4 |
| 9 | Vendet për të ushtruar janë shumë larg për mua. | 75 | 2.36 | 2.00 | 2 | .880 | 1 | 4 |
| 10 | Ushtrimet më bëjnë të ndihem i relaksuar | 75 | 3.55 | 4.00 | 4 | .643 | 2 | 4 |
| 11 | Ushtrimet më mundësojnë të kem kontakt me miqtë dhe personat qe | 75 | 2.93 | 3.00 | 3 | .920 | 1 | 4 |
| 12 | Unë jam shumë i sikletosur kur duhet të ushtruj. | 75 | 1.85 | 2.00 | 2 | .748 | 1 | 4 |
| 13 | Të ushtruarit të më ruan nga presioni i lartë i gjakut. | 75 | 3.17 | 3.00 | 3 | .724 | 1 | 4 |
| 14 | Marrja me ushtrime është shumë e kushtueshme. | 75 | 2.51 | 2.00 | 2 | 1.045 | 1 | 4 |
| 15 | Ushtrimi i rregullt rrit nivelin tim të përgatitjes fizike. | 75 | 3.41 | 4.00 | 4 | .680 | 1 | 4 |
| 16 | Oraret e punës të palestrave të ushtrimeve nuk janë të përshtatshme | 75 | 2.16 | 2.00 | 2 | .823 | 1 | 4 |
| 17 | Tonusi im muskolor është përmirësuar me ushtrim. | 75 | 3.32 | 3.00 | 3 | .640 | 1 | 4 |
| 18 | Ushtrimi përmirëson funksionimin e sistemit tim kardiovaskular. | 75 | 3.01 | 3.00 | 3 | .762 | 1 | 4 |
| 19 | Unë jam i lodhur nga ushtrimi. | 75 | 1.92 | 2.00 | 1 | .866 | 1 | 4 |
| 20 | Me anë të ushtrimeve më është përmirësuar ndjenjat e mirëqenies | 75 | 3.07 | 3.00 | 3 | .811 | 1 | 4 |
| 21 | Bashkëshorti im (Partneri), nuk me inkurajojnë për të ushtruar. | 75 | 2.08 | 2.00 | 1 | .969 | 1 | 4 |
| 22 | Ushtrimi rrit qëndrueshmëri tim. | 75 | 3.45 | 4.00 | 4 | .722 | 1 | 4 |
| 23 | Ushtrimi përmirëson fleksibilitet tim. | 75 | 3.32 | 3.00 | 4 | .738 | 1 | 4 |
| 24 | Ushtrimi më merr shumë kohë nga marrëdhëniet familjare. | 75 | 2.29 | 2.00 | 2 | .835 | 1 | 4 |
| 25 | Rregullimi ime është përmirësuar me ushtrim. | 75 | 3.19 | 3.00 | 3 | .730 | 1 | 4 |
| 26 | Ushtrimet më ndihmojnë të fle më mirë gjatë natës. | 75 | 3.39 | 4.00 | 4 | .787 | 1 | 4 |
| 27 | Nëse ushtruj rregullisht, do të jetojnë më gjatë. | 75 | 3.07 | 3.00 | 3 | .875 | 1 | 4 |
| 28 | Unë mendoj se njerëzit në veshje sportive duken qesharak. | 75 | 1.65 | 1.00 | 1 | .893 | 1 | 4 |
| 29 | Ushtrimet me ndihmojnë të çlodhem (zvogëloj lodhjen). | 75 | 2.99 | 3.00 | 3 | .846 | 1 | 4 |
| 30 | Ushtrimi është një mënyrë e mirë për të takuar njerëz të rinj. | 75 | 3.03 | 3.00 | 3 | .838 | 1 | 4 |
| 31 | Qëndrueshmëria ime fizike është përmirësuar duke ushtruar. | 75 | 3.49 | 4.00 | 4 | .554 | 2 | 4 |
| 32 | Ushtrimet përmirësojnë vetë-vlerësimin tim. | 75 | 2.84 | 3.00 | 3 | .916 | 1 | 4 |
| 33 | Familjarët e mi nuk me inkurajojnë mua për të ushtruar. | 75 | 2.40 | 2.00 | 1 | 1.139 | 1 | 4 |
| 34 | Ushtrimi rrit vigjencë time mendore. | 75 | 3.20 | 3.00 | 3 | .717 | 2 | 4 |
| 35 | Ushtrimet më mundësojnë të kryej aktivitetet normale pa u ndier i | 75 | 3.19 | 3.00 | 3 | .766 | 1 | 4 |
| 36 | Ushtrimet përmirësojnë cilësinë e punës sime. | 75 | 3.01 | 3.00 | 3 | .846 | 1 | 4 |
| 37 | Ushtrimet marrin shumë kohë nga përgjegjësitë e mia familjare. | 73 | 2.36 | 2.00 | 2 | .933 | 1 | 4 |
| 38 | Ushtrimi është argëtim i mirë për mua. | 75 | 3.44 | 4.00 | 4 | .793 | 1 | 4 |
| 39 | Ushtrimi rrit provueshmërinë time nga të tjerët. | 75 | 3.07 | 3.00 | 3 | .859 | 1 | 4 |
